



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.71/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Afijete Sada-Glllogjani dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Antigona Murati, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Naser Hisenaj, ka paraqitur apel kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 22.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pa rregullt apeli i Naser Hisenaj nga Suedia, me numër Anr.71/2019 e datës 30.10.2017, e parashtruar kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës.

A r s y e t i m

Me datën 20.09.2019, PZAP-i ka pranuar një apel nga Naser Hisenaj, me të cilën pretendohet se Arianita Hisenaj ka aplikuar për regjistrim jashtë vendit për zgjedhjet e parakohshme 2019, po ashtu ju është konfirmuar se ju ka pranuar regjistrimi mir po emri i saj nuk është në listën e votuesve, edhe pse siq thekson dokumentacionin e ka në rregull si dhe motra e saj Era Hisenaj dhe nuk janë të përfshira në listën e votuesve jashtë Kosove.

Parashtruesi i apelit ka bashkangjitur formularin e aplikimit jashtë Kosovës e nënshkruar nga Arianita Hisenaj, së bashku me kopjet e dokumentet e identifikimit valid. Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e pa rregullt

Paneli i PZAP-it, nga shkresat e lëndës vlerësoj se apeli i parashtruar nga ana e Naser Hisenaj është e parregullt, sepse parashtruesi i apelit nuk ka poseduar autorizim për të paraqitur apel në emër të Arianita Hisenaj dhe si i tillë apeli nuk i plotëson standartet e kërkuara sipas Rregullës Nr.02/2015 të nenit 10.6 ku përcaktohet se: *Apelet duhet të dorëzohen me shkrim dhe të nënshkruara nga parashtruesi i apelit apo në emër të tij nga personi i autorizuar.*

Prandaj Paneli, nuk u lëshua fare në meritat e apelit, ngase nuk janë plotësuar kriteret e kërkuara ligjore nga dispozita e lartëtheksuar.

Nga arsyet e sipërshënuara e në mbështetje të nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it (Nr.02/2015) dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika a) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.71/2019 më datën 22.09.2019.

Kryesuesi i Panelit
Faton Ademi



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.